

Nr. prot 34
okt 24/05/2015



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Nr. 3446 Prot.

Tiranë, më 28. 4. 2015

Drejtuar: “ KOMBINATI I SHEQERIT ” SH.A ✓

MALIQ

Lënda : Miratohet statuti i shoqërisë “ Kombinati i Sheqerit ” sh.a Maliq.

Pasi shqyrtuam projekt statutin e paraqitur për miratim nga shoqëria “Kombinati i Sheqerit ” sh.a Maliq, konstatojmë se ai është hartuar në zbatim të dispozitave të nenit 230 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Për këto arsye bazuar në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 8237, datë 01.09.1997 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 “ Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, nenit 216 e në vijim të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, me cilësinë e aksionarit të vetëm të “ Kombinati i Sheqerit ” sh.a Maliq, miratoj statutin e shoqërisë.

Ngarkohet “Kombinati i Sheqerit ” sh.a Maliq, për kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” Seksioni III, Regjistrimi fillestar, neni 32,36.

ARBEN AHMETAJ



STATUTI

SHOQËRIA ANONIME " KOMBINATI I SHEQERIT " SH.A.MALIQ

(i ndryshuar)

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901,datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" neni 135, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.41,datë 21.1.2015 Ministri në pozicionin e Asamblesë së Përgjithshme miraton ndryshimet në Statutin e shoqërisë anonime sh.a. " Kombinati i Sheqerit " Maliq.

Neni 1

EMËRTIMI DHE SELIA

Shoqëria anonime "Kombinati i Sheqerit" sh.a Maliq është krijuar nga transformimi i ish – ndërmarrjes shtetërore Kombinati i Sheqerit Maliq.
Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërtohet " Kombinati i Sheqerit" sh.a Maliq.
Selia e shoqërisë është në qytetin e Maliqit.

Neni 2

OBJEKTI I SHOQËRISË

Administrimi i pronave të shoqërisë.

Dhënia me qira e objekteve për të mundësuar kryerjen e aktivitetit të shoqërisë në përputhje me këtë statut.

Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të tjera, krijimin e sipërmarrjeve të tjera dhe pjesëmarrjen në sipërmarrje të tjera si brenda ashtu dhe jashtë vendit pa cënuar objektin e shoqërisë.

Neni 3

KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë ka qënë 550 000 000 + vlerën e truallit 58 366 080 = 608 366 080 lekë. Në shumën e kapitalit themeltar të shoqërisë është përfshirë dhe vlera e truallit me një sipërfaqe prej 121 596 m².

Kapitali aktual i shoqërisë është 582 418 452 lekë i ndarë në 582 418 aksione të së njëjtës kategori të cilat zotërohen tërësisht nga shteti.

Vlera nomimale e aksionit është 1.000 lekë.

Në shumën e kapitalit aktual të shoqërisë është përfshirë dhe vlera e truallit me një sipërfaqe prej 117 522.5 m².

Neni 4

TRANSFERIMI I AKSIONEVE NË RAST PRIVATIZIMI

Transferimi i aksioneve në rast privatizimi do të kryhet me vendim të Ministrit në zbatim të legjislacionit në fuqi për privatizimet.

Neni 5

ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME

Të drejtat e aksionarëve, për çështje të lidhura me veprimtarinë dhe funksionimin e shoqërisë ushtrohen nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm.(Ministri)

Neni 6

KOMPETENCAT E ASAMBLESESË TË PËRGJITHËSHME

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

1. Përcaktimin e politikave tregtare
2. Ndryshimin e Statutit .
3. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
4. Emërimin e Administratorit dhe të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.
5. Miratimin e skemës së shpërblimit të personave të përmendur në pikën 3 të këtij neni.
6. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar.
7. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë të veprimtarisë.
8. Të gjitha vendimet e mara nga aksionari i vetëm regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen. Duhet regjistruar në veçanti por pa u kufizuar në to vendimet e mëposhtme:
 - a- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
 - b- Shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve.
 - c- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit.
 - d- Vendimet për investime.
 - e- Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.
9. Të gjitha kompetencat e tjera të përcaktuara në nenin 135 të ligjit nr.9901,date 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
10. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore dhe sipas parashikimeve në Statut.
11. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së përgjithshme thirret të paktën 1(një) herë në vit.
12. Mbledhja e Asamblesë së përgjithshme thirret nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori .
13. Organi që thërret mbledhjen përcakton rendin e ditës, vendin dhe orën e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

14. Asambleja e Përgjithshme mund të përcaktojë rregulla për procedurat e mbajtjes së mbledhjes dhe pjesëmarrjes në asamble.
15. Asambleja e përgjithshme drejtohet nga Ministri.

Neni 7

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Asambleja e Përgjithshme.
2. Këshilli Mbikëqyrës
3. Administratori.

Neni 8

KËSHILLI MBIKQYRËS

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë përbëhet nga 3(tre) anëtarë:

- Alban Beqaj
- Ismet Lala
- Klarita Rexhepaj

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës miratohen dhe shkarkohen nga Ministri me cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

Kohëzgjatja e funksionit të tyre është 3(tre) vjet. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë të rizgjedhshim.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme (Ministri).

Kohëzgjatja e funksionit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 3(tre) vjet. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të rizgjidhen.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë persona fizikë. Ata nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri.

Nëse një ose disa vende të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës mbeten bosh për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqje; zëvendësimi duhet të kryhet jo më pak se 3(tre)muaj.

Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës i emëruar me zëvendësim të një anëtari tjetër përfundon mandatin e paraardhësit.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 2(dy) këshilla mbikëqyrës të shoqërive anonime që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

KRYETARI DHE ZËVENDËSKRYETARI I KËSHILLIT MBIKQYRËS

Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet natave të tij kryetarin dhe zëvendëskryetarin të cilët ngarkohen të mbledhin këshillin dhe drejtojnë diskutimet. Ata zgjidhen për gjithë kohën e mandatit të tyre dhe janë të rizgjedhshëm.

Neni 10

VENDIMET E KËSHILLIT MBIKQYRËS

1. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet sa here që e kërkon interesi i shoqërisë, me thirrjen e kryetarit, në mungesë të tij të zëvendëskryetarit dhe administratorit.
- Kryetari duhet të thërrasë këshillin mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kur administratori ose 1/3 e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.

- Në parim njoftimi për mbledhje bëhet 3(tre) ditë para me letër, fax ose E-mail, në njoftim të jetë i përcaktuar rendi i ditës. Thirrja mund të jetë e vlefshme dhe me gojë dhe pa afat nëse anëtarët e këshillit mbikëqyrës e pranojnë atë.

- Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës bëhet në selinë e shoqërisë.

2. Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash ; në rast votash të barabarta vota e kryetarit është përcaktuese.

3. Këshilli Mbikëqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje i cili nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

4. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës regjistrohen në librin e vendimeve të firmosura nga kryetari ose në mungesë të tij nga zëvendëskryetari.

5. Kopjet e vendimeve vërtetohen nga kryetari ose në mungesë të tij nga zëvendëskryetari.

Neni 11

KOMPETENCAT E KËSHILLIT MBIKQYRËS

Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

1. Të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë.
2. Të përgatisë me kërkesë të asamblesë së përgjithshme marrjen e masave që janë në kompetencë të kësaj të fundit, ti rekomandojë asaj vendime të nevojshme për tu marrë si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë.
3. Të emërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë.
4. Të përcaktojë shpërblimin e administratorit.
5. Të miratojë strukturën e shoqërisë, personelin ndihmës si dhe pagat e tyre të paraqitura nga administratori i shoqërisë.
6. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar këshilli mbikëqyrës i kërkon administratorit të paraqesë llogaritë vjetore me qëllim verifikimin dhe kontrollin e tyre.
7. Të miratojë pasqyrat financiare, llogarite vjetore si dhe raportin vjetor të paraqitura nga administratori të cilat të paraqiten asamblesë së përgjithshme.
8. Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i shikon të përshtatshme.

9. Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare.
10. Këshilli Mbikëqyrës i kërkon Administratorit informacion mbi veprimtarinë e shoqërisë të paktën një here në 3(tre) muaj.
11. Të kujdeset që shoqëria të zbatojë dhe respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit.
12. Të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave për themelimin e shoqërive tregtare ose grupeve të reja.
13. Të kryejë veprimet e tjera të përcaktuara në ligj dhe statut.

Neni 12

SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 13

ADMINSTRATORI I SHOQËRISË

Administratore e shoqërisë është Zj. Pranvera Begolli, e cila do të ushtroj kompetencat sipas ligjit dhe këtij statusi për një periudhë 3-vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i shoqërisë emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës kur për të janë dakord jo më pak se 2/3 e anëtarëve të këtij këshilli. Ai mund të zgjidhet ndërmjet personave të shoqërisë

Administratori i shoqërisë emërohet për një periudhë 3(tre) vjeçare.

Administratori i shoqërisë është i ri emërueshëm, ai ose ajo nuk mund të jetë mbi moshën 65 vjeç.

Administratori i shoqërisë që mbush moshën 65 vjeç është zyrtarisht i shkarkuar.

Administratori mund të shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës ose Asambleja e Aksionarëve, vetëm për shkaqe të përligjura.

Mënyra dhe masa e shpërblimit të tij përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës në aktin e emërimit të tij.

Administratori zbaton vendimet e Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 14

KOMPETENCAT E ADMINSTRATORIT

Administratori ka kompetenca të plota për të vepruar në emër të shoqërisë, ai ushtron këto të drejta:

1. Të kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë.
2. Të përfaqësoj shoqërinë tregtare.

3. Të kujdeset për mbajtjen saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë.
4. Të përgatisë dhe nënshkruaj bilancin vjetor dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat ia paraqet Këshillit Mbikëqyrës për miratim së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve.
5. Të përgatisë strukturën e punonjësve, personelit ndihmës dhe pagat e tyre si dhe t'ja paraqesë Këshillit Mbikëqyrës për miratim.
6. Të krijojë një sistem monitorimi dhe njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë.
7. Të raportojë para Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
8. Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.
9. Të kryej detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 16

EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspert kontabël të autorizuar të cilët miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Neni 17

USHTRIMI FINANCIAR

Ushtrimi financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

Neni 18

INVENTARI – LLOGARITË VJETORE

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore. Në mbylljen e ushtrimit organi administrativ harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar gjithashtu përgatit dhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar.

Inventarizimi i vlerave material bëhet jo më pak se një here në vit.

Inventari i ndërtesave, ndërtimeve të veçanta, makinerive të vendosura, instalimeve bëhet jo më vonë se 1 herë në 5 vjet.

Neni 19

REZULTATI I USHTRIMIT DHE CAKTIMI I FITIMEVE

Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, duke përfshirë tek këto të fundit amortizimet dhe provizionet.

Nga fitimet e ushtrimit të pakësuara kur është rasti me humbjet e mëparshme hiqet të paktën 5% për të krijuar rezervën e domosdoshme.

Përdorimi i fitimi bëhet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 20

Për çfarë nuk është shprehur në këtë statut i referohet dispozitave të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.41, datë 21.1.2015 ky Statut firmoset nga Ministri i M.ZH.E.T.T.S.

**MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES**

ARBEN AHMETAJ

